



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.3/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e Gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas Kërkesa për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e të pandehurit D.H.; nga Prizreni ndaj Gjyqtari L.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.20.02.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të pandehurit D.H., nga Prizreni parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kundër Gjyqtarit L.B.; gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren për inicimin e procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës pandehuri D.H.; nga Prizreni në ankesën e parashtruar kundër gjyqtarit L.B., ka cekur se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.291 /20 me dt. 07.10.2021 i cili është bërë i plotfuqishëm me Aktgjykim të Gjykatës së Apelit PAI.nr.02/2022 të dt. 13.03.2022 ku është dënuar me Gjobë në lartësi prej 700€ për veprën penale të ngacmimit nga neni 186 par. 1 të KPK. Në vazhdim ka cekur se edhe gjyqtari G.K., ka ndikuar në këtë çështje dhe së bashku me gjyqtarin e çështjes L.B., gjatë tërë kohës e kanë fyer dhe i kanë ndihmuar të dëmtuarës prandaj pa bazë është dënuar për një vepër që nuk e ka kryer. Bazuar në këto rrethana konsideron se Aktgjykimet janë plotësisht të pabaza dhe ka propozuar që lënda të kthehet në rigjykim.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shiqimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes L.B., dhe ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës dhe pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore pasi që pretendimet e të pandehurit D.H., se në lëndën penale P.nr.291 /20 të dt. 07.10.2021 ka gjykuar gjyqtari L:B., e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me gjobë në lartësi prej 700€ nuk qëndron sepse në lëndën penale P.nr.291/20 të dt. 07.10.2021 gjyqtar gjykues ka qenë gjyqtari G.K., të cilin Aktgjykim e ka Vërtetuar Gjykata e Apelit që ka vendosur sipas ankesës së të akuzuarit D.H., me numër PAI.nr.01/2022.Nga kjo rrjedh se gjyqtari L:B., nuk e ka gjykuar të akuzuarin sipas lëndës për të cilën ai pretendon dhe se ai nuk e ka dënuar me gjobë në shumë prej 700€.

Është fakt se në këtë çështje fillimisht ka qenë I ngarkuar me këtë lëndë Gjyqtari L:B., me numër të lëndës P.nr.1530/17 ku I akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjobë në shumë prej 500€, I akuzuari D.H., ka parashtruar ankesë dhe gjykata e Apelit e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe ka marrë numrin e lëndës P.nr.291/20 për të cilin I akuzuari D.H., ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit nga kjo lëndë dhe UI) — Kryetari I Gjykatës A.S., me Aktvendim IV.GJA.nr. 1/20-93 e ka aprovuar kërkesën e të akuzuarit dhe lënda i është caktuar gjyqtarit G.K., i cili edhe e ka përfunduar këtë lëndë me aktgjykim. Ndaj këtij Aktgjykimi D.H., ka parashtruar ankesë e cila është refuzuar dhe çështja është vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Pretendimet e të pandehurit se gjyqtari L:B., e ka ofenduar dhe ka ndihmuar të dëmtuarën nuk janë vërtetuar në asnjë procesverbal dhe në asnjë ankesë të cilën e ka cekur I pandehuri D.H., I cili ka pasur të drejtë dhe I ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore në këtë drejtim . Andaj, bazuar në të lartcekura në rastin konkret nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe prokurorëve nr. 06/1—067.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.3/2023 me datë 20.02.2023

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



KËSHILLA JURIDIKE: Ndaj këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.